



## REPUBLIKA E KOSOVËS / REPUBLIKA KOSOVA

**Ka.nr.333/2020**

**GJYKATA E APELIT E KOSOVËS**, në Kolegjin e përbërë nga gjyqtarët: Biljana Rexhiq kryetare e Kolegjit, Ferit Osmani dhe Shqipe Qerimi anëtarë, me pjesëmarrjen e zyrtares ligjore Rrezarta Bala, duke vendosur sipas ankesës të paraqitur nga ushtruesi i kërkesës Inspektorati për Mbrojtjen e Mjedisit., kundër aktgjykimit të Gjykatës Themelore në Pejë-Dega në Istog-Divizioni i Kundërvajtjes, K.nr.211/2018, të dt.02.06.2020, në bazë të nenit, 55.3 dhe 78, konform nenit 143 par.1 dhe 2, të Ligjit për Kundërvajtje, më dt.14.09.2020, merr këtë:

### AKT GJYKIM

**REFUZOHET** ankesa e paraqitur nga ushtruesi i Kërkesës si e pabazuar, **VËRTETOHET** aktgjykimi i Gjykatës Themelore në Pejë-Dega në Istog-Divizioni i Kundërvajtjes, K.nr.211/2018, të dt.02.06.2020, si i drejtë dhe i bazuar në Ligj. Nga një kopje të këtij aktgjykimi duhet dorëzuar palëve.

### Arsyetim

Gjykata Themelore në Pejë-Dega në Istog-Divizioni i Kundërvajtjes, K.nr.211/2018, të dt.02.06.2020, ndaj të pandehur in [REDAKTUAR] nga fsh.Vrellë K.Istog, me person juridik [REDAKTUAR] ka nxjerr aktvendim, sipas të cilit është pezulluar procedura kundërvajtëse, për shkak të kundërvajtjes nga neni 81, 82, 83 të Ligjit për Mbrojtjen e Mjedisit dhe Planifikimit Hapësinorë, pasi që ka ardhur deri te parashkrimi absolut i ndjekjes, konform nenit 42 par.4, lidhur me nenin 126 par.1 dhe 7 të Ligjit për Kundërvajtje.

Kundër këtij aktvendimi ushtruesi i kërkesës ka ushtruar ankesë për shkak të rishqyrtimit të lëndës, pasi që është nxjerrur aktvendim për pezullim të procedurës kundërvajtjes, në të cilën veç tjerash thekson se; në këtë çështje kundërvajtëse gjykata e shkallës së parë nuk e ka bazuar aktvendimin në argumentet të cilat janë iniciuar nga inspektorati i mjedisit, ngase i njëjti ka vepruar sipas autorizimeve ligjore dhe afateve ligjore të përcaktuara sipas legjislacionit në fuqi mbi mbrojtjen e mjedisit, e gjithashtu iniciimi i procedurës është bërë në drejtim të operatorit në fjalë u cili nuk ka vepruar sipas obligimeve ligjore të cekura në procedurën e iniciuar ndaj të njëjtit, ashtu që pasi që gjykata e shkallës së parë nuk i ka vlerësuar pretendimet nga Kërkesa.

I propozon Gjykatës së Apelit-Divizioni i Kundërvajtjes, që ankesa të aprovohet si e bazuar dhe çështja kundërvajtëse ti kthehet gjykatës së shkallës së parë në rigjykim dhe rivendosje.

Kolegji, duke i vlerësuar thëniet në ankesë, aktgjykimin e goditur dhe shkresat tjera të lëndës, konstatoi se ankesa e paraqitur është e pa bazuar dhe refuzohet, aktgjykimi i goditur vërtetohet si i drejtë dhe i bazuar në ligj.

Kolegji i Gjykatës së Apelit, konstatoj se në këtë çështje kundervajtëse, procedura nuk ka arritur që të përfundoj brenda dy viteve për shkaqe objektive dhe pasi që prej ditës kur është kryer kundërvajtja me dt.25.04.2018 e deri ne momentin kur është nxjerr aktvendimi i gjykatës së shkallës së parë kanë me dt.02.06.2020 kanë kaluar më tepër se dy vite, aktvendimi i nxjerr është bazuar në nenin 42.4, lidhur me nenin 126 par.1 dhe 7 të Ligjit për Kundërvajtje dhe është pezulluar procedura kundervajtëse, sepse ka arritur deri te parashkrimi absolut i ndjekjes kundervajtëse.

Konform nenit 143 par.1 dhe 2 të LK-së, u vendos si në dispozitiv të këtij aktgjykimi.

Kundër këtij aktgjykimi nuk është e lejuar ankesa.

**GJYKATA E APELIT E KOSOVËS,**  
Ka.nr.333/20, me dt.14.09.2020

**Zyrtarja ligjore.**  
Rrezarta Bala

**KRYETARJA E KOLEGJIT,**  
Biljana Rexhiq